

VENDIM
Nr. 158, datë 9.7.2018

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “DON-UCD” SHPK, NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar; si dhe në zbatim të nenit 4, pika 1, germa “e”; të nenit 5, pika 1, germa “e” dhe të nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.7.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut për licencimin e shoqërisë “DON-UCD” sh.p.k. në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike,

konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 475, datë 27.6.2018, shoqëria “DON-UCD” sh.p.k. ka paraqitur në ERE kërkesën për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 149, datë 28.6.2018, ka filluar procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “DON-UCD” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje, me shkresën nr. 55/44 prot., datë 28.6.2018, u publikua në media njoftimi për fillimin e kësaj procedure.

- Me shkresën nr. 475/1 prot., datë 28.6.2018, iu kërkuar subjektit plotësimi i dokumentacionit të munguar që kishte të bënte me nenin 9, pika 4.8, germa “a” (sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t’u tregtuar).

- Në vijim të kësaj korrespondence, subjekti, me shkresën nr. 475/2 prot., datë 28.6.2018, ka paraqitur në ERE tabelën me sasitë e parashikuara të energjisë, për t’u tregtuar për 5 vite të aktivitetit.

- Aplikimi i shoqërisë “DON-UCB” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE, në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, si më poshtë:

- formati i aplikimit (neni 9, pika 1): plotësuar në mënyrë korrekte.
- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2): plotësuar në mënyrë korrekte.
- dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3): plotësuar në mënyrë korrekte.
- dokumentacioni teknik për veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike (neni 9, pika 4.8): plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “DON-UCD” sh.p.k. në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike, për një afat 5-vjeçar

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti